



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:106793
Datë: 22.03.2024
Numri i dokumentit: 05492935

C.nr.1706/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Taulant Rexhëbeqaj, me bashkëpunëtoren profesionale H.D. në çështjen juridike kontestimore të paditësit B.I. me numër personal nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqësojnë A.A. dhe Z.S. të dy avokat nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson B.M. avokat nga Prizreni, me objekt të padisë kompensimi në bazë të punës me klasa të kombinuara, vlera e kontestit 2,700.00 euro, jashtë seance, me datë **22.03.2024**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit B.I. nga Prizreni, ashtu që **DETYROHET** e paditura, Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit, në emër të shpërblimit për punën e kryer me klasë të kombinuara për periudhën nga data 01.05.2019 deri me 31.12.2021, apo gjithsej 32 muaj, ti paguaj 20 % të pagës bazë, në shumë prej 84.20 € për muaj, e në shumë të përgjithshme prej **2,694.40 € (dymijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e katër euro, e dyzetë cent)**, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

II. DETYROHET e paditura që paditësit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej **144.00 € (njëqind e dyzetë e katër)**, në afat prej 7 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm

A r s y e t i m

Paditësi B.I. nga Prizreni, përmes të autorizuarve të tij A.A. dhe Z.S. avokat nga Prizreni, pranë kësaj gjykate, me datë 26.05.2022, ka parashtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson B.M. avokat nga Prizreni, me objekt të padisë kompensimin në bazë të punës me klasë të kombinuara, vlera e kontestit 2,700.00 euro.

Të autorizuarit e paditësit në padi kanë theksuar se paditësi është në marrëdhënie pune si mësimdhënësi në Shkollën Fillore të Mesme të ulës "Bajram Curri", në fshatin Romajë, komuna e Prizrenit. Bazuar në Kontratën Kolektive të e cila ka hyrë në fuqi me datë 17.04.2017 dhe Kontratën e cila ka hyrë në fuqi në vitin 2021, paditësi i ka plotësuar kushtet që në bazë të nenit 11, par.3 dhe 4 të këtyre kontratave, punëdhënësi Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, të ia kompensoi 20 % të pagës për punën e kryer me klasa të kombinuara. Paditësit i takon e drejta në kompensim të shpërblimit në lartësi prej 20 % të pagës për

periudhën 01.05.2019 deri me 31.12.2021, apo gjithsej 32 muaj punë, në shumë prej 2,694.40 euro, paga bazë 421.00 euro x 20 % = 84.20 euro x 32 muaj pune = 2,694.40 euro. E paditura deri në paraqitjen e padisë nuk e ka përmbushur detyrimin bazuar në dispozitat e kontratës së lartcekur. Përmes të autorizuarit të tij, paditësi ka parashtruar kërkesë pranë të paditurës me qëllim të kompensimit të shpërblimit për punën me klasë të kombinuara, mirëpo e paditura Drejtoria Komunale e Arsimit, me vendimin e datës 19.04.2022, e ka refuzuar kërkesën e paditësit, me arsyetim se kontrata kolektive nuk gjen zbatueshmëri në Ministrinë e Financave. Andaj, gjykatës i ka propozuar që të merr vendim dhe kërkesëpadinë e paditësit ta aprovon në tërësi si të bazuar.

E paditura, përmes të autorizuarit të saj, në përgjigjen në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësi si të pabazuar, lidhur me kompensimin e punës me klasë të kombinuara. Duke theksuar se pretendimet e paditësit se i takon kompensimi i punës me klasë të kombinuara nuk janë të bazuara, sepse mësimdhënësi posedon kontratë të punës me të cilën është precizuar se gjatë javës janë 40 orë pune dhe paga është fikse ashtu si janë dakorduar me punëdhënësin në këtë kontratë dhe në kontratë nuk është asnjë ankesë që parashih një pagesë të tillë. Paditësi ka parashtruar padi për kompensimin të punës për punën që punon me klasë të kombinuara pa e pasur parasysh se nuk e dëshmon sa është numri i nxënësve në paralelen apo klasën në të cilën punon paditësi, në këtë rast nuk mund të bazohet mbi faktin se ka ngarkesë, ku dihet se një klasë e rregullt duhet ti ketë deri në 28 nxënës. Tutje ka shtuar se përfitues të beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit – SBASHK, ndërsa paditësi nuk ka ofruar ndonjë provë që është anëtarë i sindikatës. Po ashtu e drejta e paditësit për kompensimin e punës me klasë të kombinuara për deri me 26.05.2019 është parashkruar, konform nenit 87 të Ligjit të Punës. Të paditurës nga ana e Ministrisë së Financave nuk i është ndarë kod buxhetor për përmbushjen e obligimeve që dalin nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017, andaj e njëjta nuk ka mundësi ligjore për të përmbushur këtë obligim, pasi që bie në kundërshtim me Ligjin për Buxhetin Nr.08/L-066. Gjithashtu e paditura ka theksuar se padia e paditësit është në kundërshtim me nenin 90 par.1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, pasi sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet mes organizatës së punëdhënësit dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë pale nënshkruese e saj, andaj gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzojë si të pabazuar.

Për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata ka vlerësuar provat si në vijim: Kontratën e Punës për Mësimdhënësin, me numër të protokollit 145, të datës 20.10.2015, të lidhur në mes të paditësit B.I. dhe të paditurës Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Shkencës, në Prizren; vërtetimin me numër 133/22, të datës 30.03.2022, të lëshuar nga Drejtori i Shkollës Filllore të Mesme të Ulët “Bajram Curri”, Romajë.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 152 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e themeltë, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata, përmes Kontratës së Punës për Mësimdhënësin, me numër të protokollit 145, të datës 20.10.2015, të lidhur në mes të paditësit B.I. dhe këtu të paditurës Drejtoria Komunale e Arsimit, në Prizren, vërtetoi faktin se paditësi është në marrëdhënie pune pranë të paditurës që nga data 01.09.2015, në vendin e punës Mësues Klasor, në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët “Bajram Curri”, Romajë.

Gjykata, përmes vërtetimit me numër 133/22, të datës 30.03.2022, të lëshuar nga Drejtori i Shkollës Filllore të Mesme të Ulët “Bajram Curri”, Romajë, vërtetoi faktin se paditësi B.I. punon pranë kësaj shkolle, në paralelen Lukinaj, me klasë të kombinuara që nga data 01.09.2017 dhe vazhdon të punojë ende. Paga bruto e tij është në lartësi prej 527.53 euro, ndërsa paga neto është 470.86 euro.

Gjykata përmes listës së pagave me numër EM00017629, të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, për periudhën 01 janar 2019, deri me 31 janar 2019 dhe 01 qershor 2020 deri me 30 qershor 2020, vërtetoi faktin se paga bazë për paditësin B.I. është në lartësi prej 421.00 euro.

Kontratën e Punës dhe Vërtetimin e lartcekur, Gjykata i pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par.1, të LPK-së, në të cilin paragraf përcaktohet se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*. Andaj meqë Kontrata e Punës për Mësimdhënës, me numër të protokollit 145, të datës 20.10.2015, dhe vërtetimi me numër 133/22, të datës 30.03.2022, janë lëshuar nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj, e të cilat si të tilla janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur, ashtu që të njëjtave, gjykata ia fali besimin e plotë, si provë me të cilat vërtetohet fakti lidhur me vendin e punës për paditësin dhe punën e tij me klasë të kombinuara. Ndërsa bazuar në listës e pagave për periudhën 01 janar 2019, deri me 31 janar 2019 dhe 01 qershor 2020 deri me 30 qershor 2020, gjykata vërtetoi faktin se paga bazë për paditësin B.I. është në lartësi prej 421.00 euro.

Bazuar në faktet e çështjes, Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), me nr. të njësisë 01B, nr.prot.2056, të datës 18.04.2017, të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, me nr.01/B, nr. prot. 105, e datës 22.01.2021, të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 22.01.2021. Konkretisht për kompensimin në bazë të punës me klasë të kombinuara për vitin 2019 dhe 2020, zbatohet kontrata e datës 18.04.2017 dhe për kompensimin në bazë të punës me klasë të kombinuara për vitin 2021, zbatohet kontrata e datës 22.01.2021.

Me nenin 11 par.3 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë me nr. 01B-2056, të datës 18.04.2017, është paraparë se: *“Mësimdhënësit që punojnë me klasë të kombinuara duhet të kompensohen për 20% mbi pagën e rregullt”*, si dhe neni 11 par. 4, i Kontratës së datës 22.01.2021, në mënyrë të njëjtë është paraparë kompensimi lidhur me punën me klasat e kombinuara për mësimdhënësit.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 152 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: *“Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij.”*, pasi që e paditura ka pasur për detyrim që paditësit si punëtor i arsimit-mësimdhënës, t’ia paguaj kompensimin për punën e kryer me

klasë të kombinuara, konform detyrimeve që rrjedhin nga dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit, të datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021, pasi që për paditësin B.I. nga Prizreni, kërkesa është bërë e arritshme për 32 muaj, përkatësisht për periudhën prej datës 01.05.2019 deri me datën 31.12.2021, fakt ky i vërtetuar nga kontrata e punës dhe vërtetimi me numër 133/22, i datës 30.03.2022. Në bazë të përlllogaritjes së gjykatës, paditësit duhet ti kompensohet shuma në lartësi prej 2,694.40 €, kjo pasi që 20 % i pagës bazë së paditësit (421.00 €), është 84.20 €, dhe për 32 muaj punë i takon shuma e përgjithshme prej 2,694.40 € (dymijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e katër euro, e dyzetë cent).

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigj në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor. Po ashtu gjykata i vlerësoi edhe pretendimet e të autorizuarit të paditurës sa i përket parashkrimit, pretendime të cilat i vlerësoi si të pabazuara, kjo pasi që paditësi kërkesën e ka të drejtuar nga data 01.05.2019, deri me datë 31.12.2021, ndërsa padinë e ka paraqitur me datë 26.05.2022, pra brenda afatit ligjor prej 3 viteve, të paraparë në nenin 87 të Ligjit të Punës.

Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet e tjera të palëve ndërgjygjëse dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, por ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 104.00 € dhe taksës gjyqësore në shumën prej 40.00 €, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 144.00 € (njëqind e dyzetë e katër).

Andaj, gjykata bazuar në arsyet dhe faktet e cekura më lartë, bazuar në nenin 143, lidhur me nenin 152 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL
C.nr.1706/2022, datë 22.03.2024

G j y q t a r i

Taulant Rexhëbeqaj

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankesë në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën.